



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.427/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “ENG IDEA sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH GEO & METRI”-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Proing & Partners” sh.p.k-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme- Ritenderim”, me nr. të prok: “623-20-1767-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Rahovec, më datën: 27.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ENG IDEA sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH GEO & METRI”-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme- Ritenderim”, me nr. të prok: “623-20-1767-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Rahovec.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme- Ritenderim”, me nr. të prok: “623-20-1767-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Rahovec.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “ENG IDEA sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH GEO & METRI”-Prizren, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “ENG IDEA sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH GEO & METRI”-Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 29.06.2020 me nr.427/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve të ndryshme- Ritenderim”, me nr. të prok: “623-20-1767-2-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Rahovec, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 10, 11, 59, 68 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 7 paragrafi 7.3, të RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt:10.07.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Komuna e Rahovecit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës shërbim, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit njoftim, parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna Rahovecit, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK me datën 18.06.2020 përmes vendimit ka refuzuar kërkesën e OE “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri –Prizren.

Neni 111, paragrafi 5, i LPP-së, shprehimisht potencon: “Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t’i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë. 1. Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri –Prizren se OE i rekomanduar për kontratë “Proing & Partners” sh.p.k & “Fidan Hasaj” B.I- Prishtinë nuk ka plotësuar kërkesën profesionale sikurse në tabelën më poshtë tëk përshtatshmëria profesionale 7.1&7.2 si:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit të Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, të lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit të Biznesit – Kopje.
		Kërkesa 2 Regjistrimi i Numrit Fiskal.	Dëshmia 2 Certifikatën e Numrit Fiskal – Kopje.
		Kërkesa 3 Regjistrimi i TVSH – së.	Dëshmia 3 Certifikatën e TVSH – Kopje.
		Kërkesa 4 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015.	Dëshmia 4 Kopje e noterizuar e certifikatës EN – ISO 9001 2015.
		Kërkesa 5 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit EN – ISO 14001 2015.	Dëshmia 5 Kopje e noterizuar e certifikatës EN – ISO 14001 2015.
		Kërkesa 6 Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë EN – ISO 45001 - 2015.	Dëshmia 6 Kopje e noterizuar e certifikatës EN – ISO 45001 - 2015.
		Kërkesa 7 Certifikata PAS 99-2012	Dëshmia 7 Kopje e noterizuar e certifikatës PAS 99-2012
		Kërkesa 8 Certifikata profesionale ISO IEC 27001 – 2013	Dëshmia 8 Kopje e noterizuar e certifikatës ISO IEC 27001 – 2013
		Kërkesa 9 OE duhet të jetë i licencuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për punë kadastrale.	Dëshmia 9 Licenca valide e lëshuar nga AKK për punë kadastrale - Kopje e noterizuar. Duhet ta posedojë OE apo njeri nga anëtarët e Grupit të Konzerciumit

Më tej, OE ankues shton: pra, konsiderojmë se grupi i OE të propozuar për kontratë nuk plotëson kërkesën nga pika 4 deri te pika 6 e kërkesave në dosjen e tenderit duke mos ofruar certifikata ISO të përshtatshme lidhur me fushën e tenderit që në këtë rast edhe për projektin në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit por certifikata janë të specifikuara si në vijim:

ISO 9001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menaxhmentit (GIS dhe Hulumtime)

ISO 14001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menaxhmentit (GIS dhe Hulumtime)

ISO 45001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menaxhmentit (GIS dhe Hulumtime)

Pra, certifikimi është vetëm për konsulentë inxhinieri dhe menaxhment në GIS dhe Hulumtime, po jo edhe për projektim veprimtari konkrete e kësaj procedure të prokurimit. Arsytimi i AK në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka anashkaluar në tërësi këtë fakt duke favorizuar grupin e OE të rekomanduar për kontratë edhe pse certifikata nuk janë adekuate dhe nuk përmbledhin lëmin për të cilën po aplikohet në tender.

Përgjigje në pretendimin e parë

Lidhur me pretendimin e parë, eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit, konkretisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, sqaron se tri certifikatat e kontestuara kanë përshkrimin e certifikatës konform kërkesës së AK dhe jo ashtu siç pretendon OE ankues. Pra, certifikata ISO 9001 2015 e OE të rekomanduar për kontratë mban titullin “Quality Management System - EN – ISO 9001 2015”, kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015”. Rrjedhimisht, “Quality Management System” dhe “Certifikata e Menaxhimit të Cilësisë” është e njëjta gjë. Sa i përket certifikatës ISO 14001 2015, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar “Environmental Mangement System - ISO 14001 2015” kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001 2015”. Pra, edhe kjo certifikatë është e njëjta sikurse në kërkesën e AK-së. Gjithashtu, sa i përket certifikatës ISO 45001 2015, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar “Occupational Health and Safety Management System - ISO 45001 2015” kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë - ISO 45001 2015”, që do të thotë se edhe kjo certifikatë është e njëjtë me kërkesën e AK-së. Për më tepër, këto certifikata janë të noterizuara ashtu siç ka qenë kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

2. Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri – Prizren se tek “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar stafin e kërkuar si në kërkesat kapaciteti teknik dhe profesional nga pika 1 ku përfshihen dëshmitë e kërkuar dokumentare si Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për stafin nga pika 1.1 deri në pikën 1.9 duke prezantuar dëshmitë dokumentare:

- Diploma ose certifikata e fitimit të titullit inxhinier për stafin profesional –inxhinerët –kopje;
- Kontratat valide e punës për stafin profesional;
- CV-të për stafin profesional –inxhinieret (original + të nënshkruar nga vetë pala)
- Lista e ATK të dëshmoje se stafi profesional është pjesë e kompanisë të paktën nga tre mujori i parë i vitit 2019 deri me tani ;
- Stafi profesional (inxhinieret) të cilat nuk janë në listën e kontributeve të dëshmohen me kontratë të punës ose para –kontrata dhe diplomë përkatëse ;
- Ne rast koncersiumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të stafit profesional;

Përgjigje në pretendimin e dytë

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit, pas shqyrtimit të diplomave, kontratave, listës së pagave të vulosura nga ATK-ja, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i

plotëson kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit lidhur me pikën 9.1&9.2 “Kapaciteti teknik dhe Professional”, ku për secilin prej inxhinierëve janë të bashkangjitura diplomat e noterizuara, kontratat e nënshkruara nga inxhinierët, CV-të, dhe lista e pagave e vulosur nga ATK-ja. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

3. Lidhur me pretendimin e trete të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri – Prizren se tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk posedon në tersi - Kërkesat 2 ku kërkohet se OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartimi i projekteve (Rrugë, ujësjellës, kanalizim matje gjeodezike, parqe, ura, hapësira gjelbërues, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj) në tri vitet e fundit nga data e publikimit për kontratë në vlerë min. 300,000.00 euro.

Dëshmia 2. Lista e projekteve të kryera në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuara në tri vitet fundit nga data e publikimit të njoftimit kontratë, duke saktësuar titujt e projekteve shumë e kontratës data e fillimit dhe data e mbarimit – duhet të dorëzohen në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga OE dhe dëshmitë e përfundimit referencat ose procesverbalet e pranimit të shërbimeve. Ne kemi pasur vetëm listën e projekteve të kryera për shërbime nga OE asnjë dëshmi të përfundimit-referenca ose procesverbale të pranimit të shërbimeve.

Përgjigje në pretendimin e tretë

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit dhe pas kontrollimit të kontratave dhe referencave për pranimin e punëve sqaron se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën 2 të pikës 9.1&9.2 të dosjes së tenderit që ka të bëjë me më saktë me kërkesën për dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (hartimi i projekteve - Rrugë, ujësjellës, kanalizim matje gjeodezike, parqe, ura, hapësira gjelbërues, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj) në tri vitet e fundit nga data e publikimit për kontratë në vlerë min. 300,000.00 euro. Për më tepër, OE i rekomanduar e tejkalon shumë e kërkuar prej 300,000.00 euro me kontrata dhe referenca. Pra, edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

4. Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri – Prizren se Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk plotëson - Kërkesat 3 ku thuhet OE duhet të jetë i pajisur me mjete stabilimentet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

Kërkesa 3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike si me poshtë 3.1 Dy set të GPS - esit, për matje Statike dhe RTK; (të jetë i kalibruar brenda një vitit te dëshmohet me certifikate të kalibrimit nga kompania e licencuar), në pronësi, 3.2. Një set të Stacionit Total, me saktësi matëse prej 3” (të jetë i kalibruar brenda një vitit te dëshmohet me certifikate të kalibrimit nga kompania e licencuar), 3.3 Një Dronë ne pronësi i dedikuar për inspektim, monitorim apo rivelim gjeodezik, i pajisur me kamera dixhitale.	Dëshmia 3 Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike qe ju i posedon Për pikën 3.1 & 3.2 si dëshmi duhet të prezantohet fatura e rregullt tatimore dhe certifikata e kalibrimit nga kompania e licencuar. Për pikën 3.3. për Dronin si dëshmi duhet të prezantohet fatura e rregullt tatimore dhe dëshmi e pagesës nga banka. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.
--	---

Ne kemi pasur vetëm listën e pajisjeve të prezantuara nga OE dhe asnjë dëshmi tjetër për posedimin e këtyre pajisjeve siç kërkohet ne dosjen e tenderit.

Me tej, OE ankues shton se kërkojmë nga AK të rishqyrtoj të gjitha pikat e dosjes se tenderit sipas dëshmive dokumentare dhe të jep vlerësimin përfundimtar për çdo pik veç e veç me përgjigjen po e plotëson kërkesat e caktuara apo jo nuk i plotëson kërkesën e caktuar i rekomanduar për kontratë.

Në arsyetimin e AK në vendimin për rishqyrtim nuk janë dhënë konstatimet e komisionit siç kemi kërkuar në kërkesën për rishqyrtim për secilin veç e veç por prapë është dhënë përgjigje e përgjithësuar. AK në vendimi thekson se grupi ynë i OE ka bërë pretendime pa fakte e vërteta qëndron se nuk kemi pasur qasje në dokumentacion dhe për këtë kërkojmë nga eksperti shqyrtues te verifikoj çdo pik të kërkesave veç e veç dhe të jap përgjigje lidhur me pretendimet tona.

Përgjigje në pretendimin e katërt

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit, pas kontrollimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, me saktësisht ofertës së anëtarit të konzorciumit “Fidan Hasaj” B.I-Prishtinë (N.SH.GEOCAD) sqaron se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën 3 pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku OE duhet të jetë i pajisur me mjete stabilimentet dhe pajisjet teknike 3.1 3.2 dhe 3.3, si dhe i njëjti posedon dëshmitë si faturat, certifikatat e kalibrimit dhe dëshmitë e pagesave nga banka, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosje të tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

5. Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri-Prizren, se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim shumëfish me të ulët se të gjitha OE të tjera konkurren në këtë tender. Mungesa e qasjes në paramasën dhe parallogarinë – çmimet njësi të rekomanduarit për kontratë nuk na jep mundësi të specifikimit të saktë të çmimeve jo normalisht të ulëta – abuzive të cilat pa dyshim gjenden në këtë ofertë. OE i rekomanduar për kontratë ka çmime jo normalisht të ulëta (ndoshta edhe më shumë se dy numra pas presjes dhjetore që është në kundërshtim me LPP dhe RrUOOP) sepse në të gjitha ato pozicione të ketë çmim të tillë është e pamundur. AK nuk ka marr parasysh fare ligjin e LPP dhe RrUOOP lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta po përkundrazi ka favorizuar grupin e OE të rekomanduar për kontratë duke anashkaluar ligjin dhe rregulloret, çmimi jo normalisht i ulët i pozicioneve të caktuara lidhet drejtpërdrejt me marrje të cilësisë së dobët të shërbimeve apo edhe mos marrje fare të shërbimeve të caktuara kështu duke rrezikuar drejtpërdrejt qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Përgjigja e AK në vendimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim potencon si në vijim: “në rast kur kriteri kryesor për dhënien është çmimi më i ulët me poentim” ju rikujtojmë se kjo bie ndesh me arsyetimin e AK lidhur me pretendimin 2 ku përgjigjet se “nuk lejohet që të eliminohet një kompani nga ndonjë aktivitet i prokurimit për kërkesat që nuk janë parashikuar në dosjen e tenderit dhe tek njoftimi për kontratë” neni 56.3 ku në dosjen e tenderit dhe tek njoftimi për kontratë kriter për dhënien e kontratës është:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒	Çmimi më i ulët
<i>Ose</i>	
☐	Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

Pra, në asnjë vend nuk potencohet se kriteri për dhënien e kontratës është “çmimi më i ulët me poentim” siç e modifikon arsyetimi i AK-së.

Përgjigje në pretendimin e pestë

Eksperti shqyrtues në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit, fillimisht sqaron se në asnjërin prej pozicioneve në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk gjenden çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Kurse, sa i përket çmimeve jo-normalisht të ulëta, eksperti shqyrtues sqaron se kriter për dhënien e kontratës ka qenë “çmimi më i ulët” por në dokumentin me titull “pjesa II (përshkrimi i çmimeve)” të ngarkuar në platformën e e-prokurimit janë peshuar çmimet për secilin pozicion. Pra, AK në këtë pjesë ka përcaktuar që peshimi i çmimit për pozicionin e parë është 5%, për pozicionin e dytë peshimi i çmimit është me 10%, për pozicionin e tretë me 10%, për pozicionin e katërt çmimi i peshuar është me 40%, e kështu me radhë. Pas peshimit të çmimeve, oferta e OE të rekomanduar për kontratë është peshuar me 0,76.

Po ashtu, eksperti shqyrtues konsideron se është përgjegjësi e AK-së që të sigurohet që të marrë shërbimet konform kontratave të nënshkruara, ku edhe neni 28.14 i RRUOPP-së ka përcaktuar që “funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar...”. Megjithatë, eksperti shqyrtues sqaron se kur autoritete kontraktuese përcaktojnë kriterin e dhënies “çmimi me i ulët i peshuar” duhet të përjashtohen dispozitat e nenit 61 të LPP-së, dhe rregullat për çmime jo normalisht të ulët, pasi që qëllimi i poentimit është eliminimi i çmimeve jo reale dhe nxjerrja e ofertës me të lire. Për më tepër edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me PSH.nr. 590/19, i datës 13.11.2019 qarte ka sqaruar kriterin e dhënies “çmimi me i ulët i peshuar”. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar ndërsa të vërtetohet njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 10.07.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri - Prizren se OE i rekomanduar për kontratë “Proing &Partners” sh.p.k & “Fidan Hasaj” B.I- Prishtinë nuk ka plotësuar kërkesën profesionale tek përshtatshmëria profesionale 7.1&7.2, ku OE ankues shton: pra, konsiderojmë se grupi i OE të propozuar për kontratë nuk plotëson kërkesën nga pika 4 deri te pika 6 e kërkesave në dosjen e tenderit duke mos ofruar certifikata ISO të përshtatshme lidhur me fushën e tenderit që në këtë rast edhe për projektin në fushën e arkitekturës dhe ndërtimit por certifikata janë të specifikuara si në vijim:
ISO 9001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menagjmentit (GIS dhe Hulumtime)

ISO 14001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menaxhmentit (GIS dhe Hulumtime)

ISO 45001 2015 Shërbime të konsulences, Inxhinierisë dhe Menaxhmentit (GIS dhe Hulumtime)

Pra, certifikimi është vetëm për konsulencë inxhinieri dhe menaxhment në GIS dhe Hulumtime, po jo edhe për projektim veprimtari konkrete e kësaj procedure të prokurimit. Arsytimi i AK në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka anashkaluar në tërësi këtë fakt duke favorizuar grupin e OE të rekomanduar për kontratë edhe pse certifikata nuk janë adekuate dhe nuk përmbledhin lëmin për të cilën po aplikohet në tender. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit, konkretisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, tri certifikatat e kontestuara kanë përshkrimin e certifikatës konform kërkesës së AK dhe jo ashtu siç pretendon OE ankues. Pra, certifikata ISO 9001 2015 e OE të rekomanduar për kontratë mban titullin “Quality Management System - EN – ISO 9001 2015”, kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN – ISO 9001 2015”. Rrjedhimisht, “Quality Management System” dhe “Certifikata e Menaxhimit të Cilësisë” është e njëjta gjë. Sa i përket certifikatës ISO 14001 2015, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar “Environmental Mangement System - ISO 14001 2015” kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001 2015”. Pra, edhe kjo certifikatë është e njëjta sikurse në kërkesën e AK-së. Gjithashtu, sa i përket certifikatës ISO 45001 2015, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar “Occupational Health and Safety Management System - ISO 45001 2015” kurse AK ka kërkuar “Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë - ISO 45001 2015”, që do të thotë se edhe kjo certifikatë është e njëjtë me kërkesën e AK-së. Për më tepër, këto certifikata janë të noterizuara ashtu siç ka qenë kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri –Prizren se tek “Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar stafin e kërkuar si në kërkesat kapaciteti teknik dhe profesional nga pika 1 ku përfshihen dëshmitë e kërkuar dokumentare si Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për stafin nga pika 1.1 deri në pikën 1.9 duke prezantuar dëshmitë dokumentare:

- Diploma ose certifikata e fitimit të titullit inxhinier për stafin profesional –inxhinierët –kopje;
- Kontratat valide e punës për stafin profesional;
- CV-të për stafin profesional –inxhinieret (original + të nënshkruar nga vetë pala)
- Lista e ATK të dëshmoje se stafi profesional është pjesë e kompanisë të paktën nga tre mujori i parë i vitit 2019 deri me tani ;
- Stafi profesional (inxhinieret) të cilat nuk janë në listën e kontributeve të dëshmohen me kontratë të punës ose para –kontrata dhe diplomë përkatëse ;
- Ne rast koncersiumi lideri duhet të këtë të paktën 60% të stafit profesional;

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën

e e-prokurimit, pas shqyrtimit të diplomave, kontratave, listës së pagave të vulosura nga ATK-ja, sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit lidhur me pikën 9.1&9.2 “Kapaciteti teknik dhe Professional”, ku për secilin prej inxhinierëve janë të bashkangjitura diplomat e noterizuara, kontratat e nënshkruara nga inxhinierët, CV-të, dhe lista e pagave e vulosur nga ATK-ja. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e trete të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri –Prizren se tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk posedon në tersi - Kërkesat 2 ku kërkohet se OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, Hartimi i projekteve (Rrugë, ujësjellës, kanalizim matje gjeodezike, parqe, ura, hapësira gjelbërues, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj) në tri vitet e fundit nga data e publikimit për kontratë në vlerë min. 300,000.00 euro.

Dëshmia 2. Lista e projekteve të kryera në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuara në tri vitet fundit nga data e publikimit të njoftimit kontratë, duke saktësuar titujt e projekteve shumë e kontratës data e fillimit dhe data e mbarimit – duhet të dorëzohen në origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga OE dhe dëshmitë e përfundimit referencat ose procesverbalet e pranimit të shërbimeve.

Ne kemi pasur vetëm listën e projekteve të kryera për shërbime nga OE asnjë dëshmi të përfundimit-referenca ose procesverbale të pranimit të shërbimeve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në bazë të dokumenteve të cilat gjenden në platformën e e-prokurimit,dhe pas kontrollimit të kontratave dhe referencave për pranimin e punëve, OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën 2 të pikës 9.1&9.2 të dosjes së tenderit që ka të bëjë më saktë me kërkesën për dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (hartimi i projekteve - Rrugë, ujësjellës, kanalizim matje gjeodezike, parqe, ura, hapësira gjelbërues, objekte shkollore-administrative-kulturore, salla sportive etj) në tri vitet e fundit nga data e publikimit për kontratë në vlerë min. 300,000.00 euro. Për më tepër, OE i rekomanduar e tejkalon shumë e kërkuar prej 300,000.00 euro me kontrata dhe referenca. Pra, edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri –Prizren se Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1&8.2 në mungesë të dokumentacionit, grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk plotëson - Kërkesat 3 ku thuhet OE duhet të jetë i pajisur me mjete stabilimentet dhe pajisjet sikurse në dosje të tenderit. Më tej, OE ankues shton: ne kemi pasur vetëm listën e pajisjeve të prezantuara nga OE dhe asnjë dëshmi tjetër për posedimin e këtyre pajisjeve siç kërkohet ne dosjen e tenderit dhe kërkojmë nga AK të rishqyrtoj të gjitha pikat e dosjes se tenderit sipas dëshmimeve dokumentare dhe të jep vlerësimin përfundimtar për çdo pik veç e veç me përgjigjen po e plotëson kërkesat e caktuara apo

jo nuk i plotëson kërkesën e caktuar i rekomanduar për kontratë. Në arsyetimin e AK në vendimin për rishqyrtim nuk janë dhënë konstatimet e komisionit siç kemi kërkuar në kërkesën për rishqyrtim për secilin veç e veç por prapë është dhënë përgjigje e përgjithësuar. AK në vendimi thekson se grupi ynë i OE ka bërë pretendime pa fakte e vërteta qëndron se nuk kemi pasur qasje në dokumentacion dhe për këtë kërkojmë nga eksperti shqyrtues të verifikoj çdo pik të kërkesave veç e veç dhe të jap përgjigje lidhur me pretendimet tona. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas kontrollimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, me saktësisht ofertës së anëtarit të konzorciumit “Fidan Hasaj” B.I- Prishtinë (N.SH.GEOCAD) sqaron se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën 3 pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku OE duhet të jetë i pajisur me mjete stabilimentet dhe pajisjet teknike 3.1 3.2 dhe 3.3, si dhe i njëjti posedon dëshmitë si faturat, certifikatat e kalibrimit dhe dëshmitë e pagesave nga banka, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në dosje të tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Eng Idea” sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH Geo&Metri-Prizren, se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim shumëfish me të ulët se të gjitha OE të tjera konkurren në këtë tender. Mungesa e qasjes në paramasën dhe parallogarinë – çmimet njësi të rekomanduarit për kontratë nuk na jep mundësi të specifikimit të saktë të çmimeve jo normalisht të ulëta – abuzive të cilat pa dyshim gjinden në këtë ofertë. OE i rekomanduar për kontratë ka çmime jo normalisht të ulëta (ndoshta edhe më shumë se dy numra pas presjes dhjetore që është në kundërshtim me LPP dhe RrUOOP) sepse në të gjitha ato pozicione të ketë çmim të tillë është e pamundur. AK nuk ka marr parasysh fare ligjin e LPP dhe RrUOOP lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta po përkundrazi ka favorizuar grupin e OE të rekomanduar për kontratë duke anashkaluar ligjin dhe rregulloret, çmimi jo normalisht i ulët i pozicioneve të caktuara lidhet drejtpërdrejt me marrje të cilësisë së dobët të shërbimeve apo edhe mos marrje fare të shërbimeve të caktuara kështu duke rrezikuar drejtpërdrejt qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Përgjigja e AK në vendimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim potencon si në vijim: “në rast kur kriteri kryesor për dhënien është çmimi më i ulët me poentim” ju rikujtojmë se kjo bie ndesh me arsyetimin e AK lidhur me pretendimin 2 ku përgjigjet se “nuk lejohet që të eliminohet një kompani nga ndonjë aktivitet i prokurimit për kërkesat që nuk janë parashikuar në dosjen e tenderit dhe tek njoftimi për kontratë” neni 56.3 ku në dosjen e tenderit dhe tek njoftimi për kontratë kriter për dhënien e kontratës është çmimi më i ulët.

Pra, në asnjë vend nuk potencohet se kriteri për dhënien e kontratës është “çmimi më i ulët me poentim” siç e modifikon arsyetimi i AK-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në asnjërin prej pozicioneve në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë nuk gjenden çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore. Kurse, sa i përket çmimeve jo-normalisht të ulëta, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kriter për dhënien e kontratës ka qenë “çmimi më i ulët” por në dokumentin me titull “pjesa II (përshkrimi i çmimeve)”

të ngarkuar në platformën e e-prokurimit janë peshuar çmimet për secilin pozicion. Pra, AK në këtë pjesë ka përcaktuar që peshimi i çmimit për pozicionin e parë është 5%, për pozicionin e dytë peshimi i çmimit është me 10%, për pozicionin e tretë me 10%, për pozicionin e katërt çmimi i peshuar është me 40%, e kështu me radhë. Pas peshimit të çmimeve, oferta e OE të rekomanduar për kontratë është peshuar me 0,76. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konsideron se është përgjegjësi e AK-së që të sigurohet që të marrë shërbimet konform kontratave të nënshkruara, ku edhe neni 28.14 i RRUOPP-së ka përcaktuar që “funksioni i vetëm i peshimit të çmimit është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet në bazë të çmimit të ofertuar...”. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kur autoritete kontraktuese përcaktojnë kriterin e dhënies “çmimi me i ulët i peshuar” duhet të përjashtohen dispozitat e nenit 61 të LPP-së, dhe rregullat për çmime jo normalisht të ulët, pasi që qëllimi i poentimit është eliminimi i çmimeve jo reale dhe nxjerrja e ofertës më të lire. Për më tepër edhe paneli shqyrtues përmes vendimit me PSH.nr. 590/19, i datës 13.11.2019 qartë ka sqaruar kriterin e dhënies “çmimi më i ulët i peshuar”. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion, si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues të prokurimit, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cilët ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me rastin e vlerësimit të ofertave ka pasur parasysh që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime më të lira se sa ofertat tjera.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Rahovec

1x1 OE -“ENG IDEA sh.p.k & Sib-bka sh.p.k @ N.SH GEO & METRI”-Prizren

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.